

VENDIM
Nr. 374, datë 20.6.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 72, DATË 7.2.2018, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO
TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT
PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2018”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 72, datë 7.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në shkronjën “a”, të nënpikës 2.7, fjalët “... nga 6 deri në 10 dhoma ...” zëvendësohen me “... nga 4 deri në 10 dhoma ...”.

2. Në shkronjën “b”, të nënpikës 2.7, fjalët “... 20 000 000 (njëzet milionë) lekë ...” zëvendësohen me “... 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë ...”.

3. Paragrafi i dytë pas shkronjës “dh”, të nënpikës 2.7, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Për masat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj nënpike, investimet do të konsiderohen edhe jashtë 100 fshatrave të përcaktuara sipas Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural (Programi i 100 fshatrave).”.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi